



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJËMBLEDHËS SEMAN

VENDIMI

Nr. 4, datë 20.12.2019

**PËR**  
**MIRATIMIN E LEJES SË SHFRYTËZIMIT TË BURIMIT UJOR**  
**REZERVUARI I QAFËS, BASHKIA SKRAPAR, QARKU BERAT, PËR**  
**QËLLIME TEKNOLOGJIKE NGA KOMPANIA "SPIECAPAG".**

Në mbështetje të nenit 50, pika 2, të ligjit nr.111/2012, i ndryshuar me ligjin 6/2018, datë 8.2.2018, për "Menaxhimin e integruar të burimeve ujore", VKM nr. 221, datë 26.4.2018, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore", si dhe të VKM-së nr. 416, datë 13.5.2015 si dhe Vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit nr. 6, datë 12.6.2019, "Për miratimin e rregullores", "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor", me propozim të Z.A.B.U. Shkumbin-Seman, Këshilli i Basenit Seman

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes "Për Shfrytëzimin e Burimit Ujor, rezervuari i Qafës" subjektit "Spiecapag", me objektiv "Shfrytëzimi i Burimit Ujor për Qëllime Teknologjike".
2. Ngarkohet Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Shkumbin-Seman për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I K B U S E M A N

BAKI BALA

